



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:068329
Datë: 13.03.2024
Numri i dokumentit: 05443522

C.nr.341/23

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Fuad Haliti, në kontestin e paditësit E.H nga Mitrovica Jugore, Rruga “A.H” pa numër, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Isa Hyseni nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokat Arbnor Murturi, për shkak të pagesave të pagave mujore të papaguara, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 13.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit E.H.

II. OBLIGOHET e paditura – Komuna e Mitrovicës, që paditësit E.H t'i paguaj shumën në lartësi prej 4,215.50€ në emër të të ardhurave personale – pagave të papaguara për periudhën Tetor, Nëntor, Dhjetor 2021 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj 2022 si dhe për katër orë mësimi në javë si mësimdhënëse e matematikës nga data 21.01.2022 deri më 27.05.2022, dhe atë:

- në emër të të ardhurave personale – pagave të papaguara shumën prej 3,225.68€ për periudhën 04.10.2021 deri më 30.05.2022 dhe kamatën prej 8% në shumën prej 500.46€, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.
- Në emër të kontributit pensional (5% në emër të punëdhënësit – 176.76€ dhe 5% në emër të punëmarrësit – 176.76€) shumën në lartësi prej 353.53€, shumë të cilën obligohet e paditura që ta transferoj nga llogaria e punëdhënësit në të mirë të llogarisë së trustit të paditësit, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.
- Në emër të tatimit në të ardhura personale shumën prej 132.84€, shumë të cilën obligohet e paditura që ta transferoj nga llogaria e punëdhënësit në Agjensionin Tatimor të Kosovës (ATK), në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

- I. OBLIGOHET** e paditura – Komuna e Mitrovicës që në emër të shpenzimeve procedurale t`i paguaj paditësit shumën prej 379.00€, në afat prej 7 ditësh nën kërcënimin e përmarimit me dhunë.

Arsyetim

1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi me datën 23.02.2023 pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, me të cilën ka kërkuar që paditësit t`ia paguaj në emër të pagave të papaguara në shumën e përgjithshme prej 3,028.02€, në emër të të ardhurave personale – pagave të papaguara për periudhën Tetor, Nëntor, Dhjetor 2021 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj 2022 si dhe për katër orë mësimi në javë si mësimdhënëse e matematikës nga data 21.01.2022 deri më 27.05.2022, me kamatë ligjore 8% nga dita e ushtrimit të padisë e gjërë në pagesën përfundimtare.

Në padi dhe në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur i autorizuari i paditësit deklaron se njoftojmë gjykatën se sa i përket obligimit për ekspertizën financiare për ekspertin gjyqësor e kemi përmbushur. Padinë dhe kërkesëpadinë nga e kërkuara për pagimin e pagave mujore për periudhën kohore Tetor 2021 e deri më Maj 2022 si dhe për 4 orë mësimi si mësimdhënëse e matematikës nga data 21.01.2022 e deri më 27.05.2022 në shumë prej 3,028.02 € e precizojmë si në vijim: për periudhën si më lartë cekur në emër të pagave të papaguara në shumë të përgjithshme prej 4,215.51€ dhe atë në emër të pagave neto shumën prej 3,225.68€, në emër të kontributit pensional dhe atë 5 % të Trustit pensional në emër të punëdhënësit dhe 5 % në emër të punëmarrësit në shumë prej 353.53€ (176.76 +176.76), në emër të tatimit të pagave shumën prej 132.84€ dhe në emër të kamatës ligjore në shumë prej 500.46 €. I propozoj gjykatës që pas administrimit të provave kërkesëpadinë e precizuar ta aprovoj në tërësi si të bazuar, pasi e njëjta është mbështetur me prova të shumta materiale si në shkresat e kësaj lënde. Konsiderojmë se pas mbajtjes së seancës kryesore dhe administrimit të provave në mënyrë të pakontestueshme u vërtetua kërkesëpadia e precizuar e paditëses si e bazuar, prandaj i propozojmë gjykatës që të njëjtën ta aprovoj si të bazuar në shumë të cekur si në precizim të kërkesëpadisë. Njëherit i kërkojmë shpenzimet e procedurës dhe atë për hartimin e padisë shumën prej 104€ për përfaqësim në një seancë gjyqësore 135€, në emër të taksës gjyqësore shumën prej 40€ dhe në emër të ekspertizës financiare në shumë prej 100 €, gjithsej në shumë prej 379 €.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor i autorizuari i të paditurës deklaron se e konfirmoj se e kemi pranuar ekspertizën financiare dhe ndaj të njëjtës kemi vërejtje për shkak se paga neto e paditësit është llogaritur në shumën prej 351.84 euro ndërsa në bazë të kontratës së punës vërtetohet që paditësi ka pasur pagë neto prej 336.80 euro. Sa i përket bazueshmërisë së kërkesëpadisë qëndroj pranë pretendimeve të parashtruara me anë të përgjigjes në padi duke kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar për shkak të mungesës së bazës ligjore. Shpenzimet e procedurës lidhur me mbajtjen e kësaj seance i kërkoj në shumën prej 135€.

2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: Kontrata e punës me nr. protokollit 09/2021 e datës 04.10.2021; Vërtetimi me nr. prot.99/2022 i datës 23.06.2022; Vërtetimi me nr.prot. 301/23 i datës 23.01.2023.; Kërkesë me nr. prot 07-120/08-0005436/28 i datës 23.01.2023; Ekspertiza financiare e datës 11.12.2023.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e **bazuar**.

3. Faktet

Me leximin e Kontratës së punës me nr.prot. 09/2021 e datës 04.10.2023 gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura Komuna e Mitrovicës Jugore si mësimdhënës i edukatës fizike në SHFMU "Avni Shabani" Zabërxhë dhe SHFMU "Bislim Hajdari" në Kaçanoll, në kohën e caktuar nga data 04.10.2021 deri më 30.05.2022 dhe ka pasur pagën mujore në shumë prej 387.46€.

Me leximin e vërtetimit me nr. prot.99/2022 i datës 23.06.2022 i lëshuar nga SHFMU "Avni Shabani" Zabërxhë, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka qenë mësimdhënësi i lëndës edukatë fizike nga data 04.10.2021 deri më 30.05.2022 si dhe nga 4 orë në javë si mësimdhënës i matematikës nga data 21.01.2022 deri më 27.05.2022.

Me leximin e vërtetimit me nr.prot.301/23 i datës 23.01.2023 i lëshuar nga SHFMU "Dëshmorët e Kaçanollit" në Kaçanoll gjykata vërtetoi faktin se paditësi E.H është i angazhuar si mësimdhënësi i edukatës fizike për periudhën 04.10.2021 deri më 30.05.2022.

Me leximin e kërkesës me nr.prot 07-120/08-0005436/28 i datës 23.01.2023 e paditësit drejtuar të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi E.H iu është drejtuar me kërkesë për pagimin e pagave mujore të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore për periudhën 04.10.2021 deri më 30.05.2022 dhe 4 orë në javë mësim për periudhën 21.01.2022 e deri më 27.05.2022.

Me leximin e ekspertizës financiare të datës 11.12.2023 të ekspertit financiar Faton Fetoshi, gjykata vërtetoi faktin se lartësia e pagave të papaguar për paditësin për periudhën Tetor 2021 deri në muajin Maj 2022, si dhe katër (4) orë mësim në javë si mësimdhënës i matematikës nga data 21.01.2022 e deri më datën 27.05.2022, është paga bruto në vlerë prej 3.535.28€, kontributi pensional i punëdhënësit është në vlerë prej 176.76€, kontributi pensional i punëtorit është në vlerë prej 176.76€, tatimi në të ardhura pensionale është në vlerë prej 132.84€ dhe paga neto është në vlerë prej 3,225.68 €.

Eksperti financiar Faton Fetoshi në seancë deklaroi se bazuar në kontratën e nënshkruar në mes të Drejtorisë së Arsimit dhe paditësit Erxhan Haxhani paga mujore e të njëjtit është 336.80€ të cilës i shtohen 4€ për përvojën e punës dhe 46.66€ është gradimi sipas kontratës, ku paga bruto

i bie të jetë 387.87€ e cila kur t'i zbriten obligimet tatimore kontributi i punëdhënësit në vlerë prej 19.37€ dhe tatimi sipas shkallëve tatimore 16.25€ paga neto i bie të jetë 351.84 €. Gjithashtu në faqen 4 të ekspertizës duhet të përmirësohet një gabim në llogaritje ku shuma e pagës neto në vend të 3535.28€ duhet të jete 3,225.68€ ndërsa shuma e përgjithshme 4, 212.51€. Sa i përket përlllogaritjes së pagës neto, shtesa për përvojën e punës si dhe shtesa në emër të gradimit nuk është llogaritur në pagën neto, mirëpo është llogaritur në pagën bruto, sepse paga bruto përbëhet nga paga bazë apo paga mujore, përvoja e punës dhe gradimi në këtë rasi dhe nga paga bruto fillon tatimi i pagës dhe kontributeve pensionale.

4. Baza ligjore

Sipas nenit 55 paragrafi 1 i Ligjit të Punës parashihet se *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit .”* Sipas paragrafi 2 të këtij neni parashihet se *“Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës.”* Sipas paragrafi 6 të këtij neni parashihet se *“Paga, paguhet në afatet e përcaktuara me Kontratë Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ose Kontratën e Punës, më së paku një (1) herë në muaj.”*

5. Vlerësimet përfundimtare të gjykatës

Gjykata pas administrimit dhe vlerësimit të provave si dhe dispozitave në fuqi, konstatoj se kërkesëpadia e paditësit është plotësisht e bazuar sepse i njëjti ka qenë në marrëdhënie punë tek e paditura si mësimdhënës i edukatës fizike për periudhën 04.10.2021 deri më 30.05.2022 dhe ka pasur pagën mujore në shumë prej 387.46€, mirëpo i njëjti për këtë periudhë kohore nuk ka pranuar kompensim e të ardhurave personale – pagat, të cilën punëdhënësi në këtë rast e paditura ka pasur obligim t'ia kompensoj në bazë të kontratës së punës nr.prot. 09/2021 e datës 04.10.2023.

Lidhur me lartësinë e pagave të papaguara, gjykata u bazua në ekspertizën financiare të ekspertit Faton Fetoshi, sipas të cilës lartësia e pagave të papaguara për paditësin për periudhën për periudhën Tetor 2021 deri në muajin Maj 2022, si dhe katër (4) orë mësim në javë si mësimdhënës i matematikës nga data 21.01.2022 e deri më datën 27.05.2022, është paga bruto në vlerë prej 3.535.28€, kontributi pensional i punëdhënësit është në vlerë prej 176.76€, kontributi pensional i punëtorit është në vlerë prej 176.76€, tatimi në të ardhura pensionale është në vlerë prej 132.84€ dhe paga neto është në vlerë prej 3,225.68 €, dhe kjo ekspertizë nuk pati kundërshtim nga palët ndërgjyqëse dhe të njëjtën gjykata e çmoj si profesionale dhe t'ia fali besimin e plotë.

Lidhur me pretendimit e të paditurës se e njëjta e ka dërguar dokumentacionin e nevojshëm në departamentin përkatës të Ministrisë së Financave në mënyrë që paditësi të përfshihet në listën e pagave, mirëpo ky departament nuk e ka bërë ekzekutimin e pagave me arsyetimin se lidhur me marrëdhënien e punës të krijuar mes të paditurës dhe paditësit nuk është zhvilluar procedura

e konkursit publik, gjykata vlerëson se ky pretendim është i pabazuar sepse paditësi kontratën e punës e ka lidhur me të paditurën dhe obligimet nga kjo kontratë i takojnë të paditurës, ndërsa fakti se pagesat bëhen përmes Ministrisë së Financave nuk nënkupton se punëdhënësi në këtë rast është Ministria. Fakti se a është zhvilluar konkurs publik apo jo nuk është objekt i vendosjes në këtë çështje kontestimore dhe lidhur me këtë gjykata nuk lëshohet në çmuarjen të mëtutjeshëm, mirëpo në këtë procedurë gjykata vendosi vetëm brenda kërkesëpadisë së paditësit dhe në bazë të provave të prezantuara pranë gjykatës.

Lidhur me shpenzimet procedurale, gjykata vendosi në bazë të nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe atë shumën në lartësi prej 104€ në emër të hartimit të padisë, 40€ në emër të taksës gjyqësore dhe 135€ në emër të përfaqësimit në një seancë dhe 100€ në emër të ekspertizës financiare, apo në total shumën prej 379.00€.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.341/2023, datë 13.03.2024

GJYQTARI
Fuad Haliti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.